



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:083261

Datë: 10.06.2024

Numri i dokumentit: 05800128

**PAKR.nr.29/2024**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Zyhdi Haziri, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Albulena Rexha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.Q., nga Mitrovica, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 par.2 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit M.Q., av.Rexhep Kaçaniku, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.205/2023, të dt.15.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.06.06.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit M.Q., av.Rexhep Kaçaniku, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.205/2023, të dt.15.12.2023, vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.205/2023, të dt.15.12.2023, është shpallur fajtor i akuzuari M.Q., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 par.2 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, si dhe dënimi me gjobë në shumën prej 300 (treqind) Euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, në afatin e paraparë ligjor, atëherë i njëjti do ti zëvendësohet në dënimin me burgim, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 Euro.

Nga i akuzuari në mënyrë të përhershme është konfiskuar sasia e narkotikut, e llojit marihuan në peshë të përgjithshme prej 12.03gr, e llojit marihuan, e cila pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, do të shkatërrohet nga ana e njësiteve përkatëse.

Është obliguar i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtarë, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro, si dhe 50Euro, në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, por jo më gjatë se aktgjykimi të merr formën e prerë.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, ankesë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit M.Q., av.Rexhep Krasniqi, për shkak të dënimit të shqiptuar duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të ndryshohet dhe të akuzuarit, M.Q., ti shqiptoj dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim do të shndërrohet në dënimin me gjobë në shumë prej 1.200 (njëmijedyqind) Euro, me qëllim që edhe me dënimin me gjobë të shqiptohet se dënim plotësues, në shumën prej 200 (dyqind) Euro, të arrihet efekti dhe qëllim i tij i paraparë në ligj.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.44/2024, të datës 25.01.2024, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit M.Q., av.Rexhep Kaçaniku, aktgjykimit të ankimuar, si dhe shkresave të tjera të lëndës, ka propozuar që ankesa e ushtruar të refuzohet si e pa bazuar, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.205/2023, i dt.15.12.2023, të vërtetohet.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.06.06.2024, dhe i ka njoftuar në mënyrë të rregullt të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar, i akuzuari M.Q., si dhe mbrojtësi i tij, av.Rexhep Kaçaniku, ndërsa nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit, përkundër asaj që ka qenë i njoftuar në mënyrë të rregullt e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.Q., av.Rexhep Kaçaniku, ka deklaruar se ngel pranë ankesës së ushtruar, dhe ka propozuar që vendimi për dënimin të ndryshohet të akuzuarit ti shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, e më pastaj ky lloj dënimi ti zëvendësohet në dënimin me gjobë, në shumën prej 1.200 (njëmijedyqind) Euro, e po ashtu dënimi me gjobë në shumën prej 300 (treqind) Euro, të zbutet në shumën prej 200 (dyqind) Euro.

I akuzuari M.Q., deklaroi se e mbështet paraqitjen e av.Rexhep Kaçaniku, si dhe ankesën e ushtruar.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit M.Q., av.Rexhep Kaçaniku, propozimit

me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, aktgjykimit të ankimuar, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

**Ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit M.Q., av.Rexhep Kaçaniku, nuk është e bazuar.**

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, kolegji i kësaj gjykate e ka shqyrtuar aktgjykimin si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parapara në kuptim të nenit 384 të KPPK, për të cilat shkelje kolegji i Gjykatës së Apelit, përkujdeset sipas detyrës zyrtare në pajtim të nenit 394 të KPPK, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, si dhe shkeljet e ligjit penal, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit M.Q., av.Rexhep Kaçaniku, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke theksuar se në këtë çështje penale, i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se ka pasur qëndrim korrekt gjatë të gjitha fazave të zhvillimit të procedurës, se në kohën kur ka kryer veprën penale dhe është shpallur fajtor ka qenë i pa martuar, kurse tani është i martuar, baba i një fëmiju, në pritje të fëmijut të dytë, se është mbajtës i vetëm i familjes, dhe e ka nënën plakë, e po ashtu ka premtuar që në të ardhmen nuk ka me ra në kundërshtim me ligjin, andaj pas vlerësimit të këtyre rrethanave jemi të mendimit se ankesa do të aprovohet dhe të mbrojturit tim, ti shqiptohet dënim më i butë.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me vendimin për dënimin, si dhe shkresat e tjera të lëndës, sipas ankesës së ushtruar nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit M.Q., av.Rexhep Kaçaniku, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës, e sidomos nga pranimi i fajësisë, nga ana e të akuzuarit, ashtu që ka vlerësuar të gjitha rrethanat me rastin e marrjes së vendimit për dënimin në kuptim të nenit 73 të KPK, e sidomos ka vlerësuar rrethanën se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën e kryer penale, se ka shpreh keqardhje dhe është penduar se ka kryer këtë veprë, se më parë nuk ka qenë i dënuar, pasi që nuk mbahet në evidencë për ndonjë veprë tjetër penale, se është i martuar, ka një fëmijë, e pasi që rrethana rënduese nuk gjeti ka vlerësuar dispozitat ligjore nga neni 75 par.1 pika 1.3 të KPK, lidhur me nenin 76 par.1 pika 14 të KPK, duke bërë zbutjen e dënimit brenda kufijve të zbutjes. Ka vlerësuar ankesën e mbrojtësit së të akuzuarit, nga e cila nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, andaj duke vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës, i ka shqiptuar dënim sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, ashtu që kolegji është i bindur që me dënimin e shqiptuar të akuzuarit sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën

penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 41 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.29/2024, të datës 06.06.2024**

**Procesmbajtësja,**  
**Albulena Rexha**

**Anëtarët e kolegjit,**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit,**  
**Xhevdet Abazi**

**Zyhdi Haziri**